



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Bordi

**VENDIM**

**Nr. 113, Datë 14.05.2018**

**PËR**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “OSOJA ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK  
SEMAN-1 SHEQ MARINAS FIER ME FUQI TË INSTALUAR 2000 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.05.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me licencimin e shoqërisë “OSOJA ENERGY” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 1, Sheq Marinas Fier me fuqi të instaluar 2000 KW,

**Konstatohet se :**

- Shoqëria “OSOJA ENERGY” sh.p.k. me shkresën e datës 11.04.2018, protokolluar në ERE me nr. 310 Prot, datë 11.04.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman – 1, Sheq Marinas Fier me fuqi të instaluar 2000 KW.
- ERE me Vendimin me nr.93 datë 20.04.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSOJA ENERGY” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-1, Sheq - Marinas, Fier me kapacitet të instaluar 2000 KW”.
- Në vijim të vendimit sipërcituar me shkresën nr. 55/20 Prot., datë 20.04.2018, u bë njoftimi në median e shkruar dhe me mbarimin e afateve të publikimit rezulton se nuk ka ndonjë kërkesë apo objeksion nga të interesuarit.
- Gjithashtu ERE me shkresën nr. 310/1 Prot., datë 26.04.2018, i ka kërkuar subjektit “OSOJA ENERGY” sh.p.k, të plotësojë dokumentacionin e munguar në aplikim për

i përket oponencës teknike të projektit të zbatimit dhe vërtetimeve nga gjykata dhe prokuroria për statusin penal.

- Me shkresën e datës 10.05.2018, subjekti ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar.
- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “OSOJA ENERGY” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “OSOJA ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Seman-1, Sheq, Marinas Fier me fuqi të instaluar 2000 KW, për një afat 20- vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**